

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURË MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	50-02	Nr i Prot. Broj Prot.	4783-2/24
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-	Data: Datum: Date:	28.06.24
PRISHTINË / A			No. 1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	20.12.2024
REFERENC-Ë:	24/4783/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"G3 Oil" Sh.p.k.Mitrovicë, Stacion i karburanteve, Shupkovc, Mitrovicë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore të operatorit "G3 Oil" Sh.p.k.Mitrovicë, Stacion i karburanteve Shupkovc, Mitrovicë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/4783/MMPHI  
Datë: 20.12.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Operatori "G3 Oil" Sh.p.k. pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Stacion i Karburanteve në Shupkovc, Mitrovicë, në ngastrën, P-71208128-011118-2, zona kadastrale Shupkovc, Mitrovicë.

2. Operatori obligohet:

- 2.1. Të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- 2.2. Në mënyrë të rregullt të mirëmbahet dhe të kontrollohet seperatori i vajrave, nga shkarkimi i ujërave nga platoja e sipërfaqes së operimit;
- 2.3. Për sistemin menaxhues mjedisore të ketë personin e profilit të mjedisit;
- 2.4. Të kontrollohen vazhdimisht kolektorët për grumbullimin e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e operimit e stacionit të karburantit, nga mbushja me sediment;
- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

Faqe 2 nga 4



## Ar sy e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "G3 Oil" Sh.p.k Shupkoc, Mitrovicë, për veprimtarinë : Stacion i Karburanteve, në ngastrën me nr. P-71208128-011118-2, zona kadastrale Shupkoc, Mitrovicë me kapacitet të rezervuarëve: V<sub>1</sub>- 30 m<sup>3</sup>, V<sub>2</sub>- 15 m<sup>3</sup>, V<sub>3</sub>- 15 m<sup>3</sup>, V<sub>4</sub>- 15 m<sup>3</sup>, V<sub>5</sub>- m<sup>3</sup>, naftë dhe benzinë., është konstatuar se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 23/5922/1-ZSP/ të lëshuar me datë: 01.03.2024;
- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent-AME me nr.0002544/23 me dt.26.05.2023;
- Certifikat e përdorimit të objektit, Nr.prot.08-350/02-0038/720/24 të datës: 07.06.2024.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike, mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore **lëshohet** për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Mitrovicë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së